

**D E K R E T**  
**Nr.645 datë 17.9.1993**

**PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR.7732, DATË 20.7.1993 "PËR VENDOSJEN E  
MBITAKSËS DOGANORE PËR MALLRAT E IMPORTIT**

Në mbështetje të nenit 28, pika 19 të ligjit nr.7491 datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozim të Këshillit të Ministrave

**D E K R E T O J:**

**Neni 1**

Në ligjin nr.7732, datë 20.7.1993, neni 1 ndryshohet si vijon:

"Të gjitha mallrat e importuara në Republikën e Shqipërisë i nënshtrohen mbitaksës së detyrueshme doganore në masën 5 për qind të vlerës së tyre doganore. Kjo mbitaksë zbatohet veç nga taksat normale të importit.

Përfshihen nga pagimi i mbitaksës doganore të gjitha rastet që përfshihen edhe nga taksat doganore e normale të importit të përcaktuara në ligjin nr.7675, datë 2.3.1993 "Për disa ndryshime e plotësime në ligjin nr.7609, datë 22.9.1992 "Për tarifat doganore".

**Neni 2**

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

**KUNDËRFIRMOHET**  
**PRESIDENTI I REPUBLIKËS**  
**Sali Berisha**  
**KRYEMINISTRI**  
**Aleksandër Meksi**